

**Data 24.04.2023  
Ora 19:54**

## **RENDI I DITËS**

**Projektvendimi: “Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.**

### **PJESËMARRJA :**

#### **KQZ:**

- **Komisioni Rregullator:**

- **Ilirjana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ Y. Merkaaj, E. Meta**
- **Parti Politike: PDIU, PL**
- **OJQ: KRIIK, ODIHR**

**Z. I. Nano:** Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Kërkojmë ndjesë për vonesën e fillimit të mbledhjes! për arsye teknike, është shtyrë fillimi i mbledhjes. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, sekretari i Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Në mbledhjen e sotme, në rendin e ditës kemi dy çështje, së pari



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

“Shqyrtimin e projektvendimit për organizmin e punës në Vendin e Numrit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Pika e dytë e rendit të ditës është një informacion i sekretarit të përgjithshëm bazuar në disa pyetje dhe kërkesa nga ana e anëtarëve të Komisionit Rregullator. Për pikën e dytë sekretari i Përgjithshëm ka kërkuar të përgatitet për mbledhjen e ardhshme, kështu që do të ftoja kolegët të votonim ndryshimin e rendit të ditës, duke hequr pikën e dytë të rendit të ditës.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***

***Me 5 vota pro miratohet.***

A kemi çështje jashtë rendit të ditës?

***Znj. H. Vukaj:*** Në emër të kolegut dhe në emrin tim kemi një çështje jashtë rendit të ditës, kështu që, pasi të mbarojë ky akt, do të fillojmë me çështjen tjetër.

***Znj. I. Nano:*** Patjetër. Atëherë, fillojmë me “Shqyrtimin e projektvendimit “Për organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”. Relaton sekretari i Përgjithshëm, ose drejtori i drejtorisë, i cili do të flasë në mënyrë të përmbledhur për projektaktin.

***Z. E. Meta:*** Faleminderit! Në përmbushje të kompetencës së parashikuar në nenin 20, pika 1 shkronjat “a” dhe “b” dhe nenet 95 dhe 115, vijues të Kodit Zgjedhor, Komisionit Rregullator i paraqitet për shqyrtim dhe miratim projektvendimi për

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

organizimin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonat e administrimit zgjedhor. Në vlerësim të rëndësisë së organizimit të punës në vendin e numërimit të votave, radhës së veprimeve gjatë dorëzimit dhe numërimit të votave për nxjerrjen e rezultatit të zgjedhjeve projektvendimi përcakton dhe detajon rregullat për organizmin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën e veprimeve numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit për zgjedhjet në organeve e qeverisjes vendore. Projektvendimi është ristrukturuar në krerë. Në kreun e parë pasqyrohen: qëllimi, detyrat e grupit të numërimit të votave, teknologjia mbështetëse e numërimit të votave; në kreun e dytë: marrja në dorëzim e materialit zgjedhor, ku pasqyrohen: caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim, detyrat e grupit të marrjes në dorëzim, marrja në dorëzim e materialit zgjedhor, kutitë e deklaruara “kuti të parregullta” sistemimi i kutive me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit në VNV; në kreun e tretë trajtohet fillimi i procesit të numrit ku pasqyrohen personat e pranishëm në VNV, veprimet paraprake të KZAZ-së, fillimi procesit të numërimit të votave dhe radha e numërimit; në kreun e katërt përcaktohen rregullat për procedurat që ndiqen për numërimin e votave nga grupet e numërimit të votave ku pasqyrohen: veprimet paraprake të GNV-së, numërimi i votave, rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit, hapja e kutive të materialeve të votimit, procedura dhe radha e veprimeve të GNV-së, llojet e votave, dhe kriteret e vlerësimit të votave, vlerësimi i votave, kontestimi dhe rivlerësimi i votës, numërimi i votave të subjekteve zgjedhore, nxjerrja e rezultatit të zgjedhësve nga grupi i numërimit për qendrën e votimit, mbyllja e kutisë me fletët e votimit; në kreun e pestë administrimi dhe numërimi i votave të hedhura gabim për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, ku pasqyrohet administrimi i votave të hedhura gabim dhe numërimi i votave të hedhura gabim; në kreun e gjashtë trajtohet nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

KZAZ-ja, ku pasqyrohen: nxjerrësja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për kryetarin e bashkisë dhe nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për këshillin e bashkisë dhe dispozitat e fundit. Për sa më lart në këtë relacion administrata e KQZ-së, nëpërmjet Komisionerit, në respektim të detyrimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 1019, datë 29.12.2008, të Kodit Zgjedhor propozon për shqyrtim dhe miratim Komisionit Rregullator projektvendimin “ Për organizmin e punës në vendin e numërimit të votave, radhën veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhorë, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonat e administrimit zgjedhor për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”.

**Znj. I. Nano:** Faleminderit, zoti Meta! Kalojmë në shqyrtimin e projektvendimit. Së pari, kemi diskutimin në parim. A keni diçka në parim për projektvendimin? Jo. Kalojmë në votimin në parim.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Fillojmë shqyrtimin nen për nen. Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve Komisioni Rregullator vendosi: Neni 1. “Qëllimi”. “Ky vendim ka për qëllim të detajojë rregullat për mënyrën e organizmit të punës, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore nga Komisioni i Qendrës së Votimit në vendin e numërimit të votave për detyrat dhe mënyrën e funksionimit të KZAZ-së dhe të anëtarëve të grupit të numërimit të votave gjatë procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor”. Kolegë? Zoti Çakaj.

**Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ**





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit! Në fakt, ndërhyrja ime ka të bëjë më shumë me bazën ligjore të parashikuar në titullin e projektvendimit. Unë sugjeroj të shtohet edhe “neni 95 i Kodit Zgjedhor” pasi në nenin 95, pika 5 parashikohet se KQZ-ja përcakton me akt normativ kriteret për numrin e grupeve të numërimit për çdo vend të numërimit të votave, mënyrën e organizmit të punës, ndarjen e detyrave midis anëtarëve të grupit të numërimit dhe rregullat për radhën e veprimeve. Pra, qartazi Kodi Zgjedhor e parashikon nenin 95 si një nen autorizues për të përcaktuar rregullat për mënyrën e organizmit të punës. Kështu që sugjeroj të shtohet te baza ligjore, pra pas fjalëve “në mbështetje të neneve 20, pika 1 shkronjat “a” dhe “b”, dhe 3,” këtu të shtohet “neni 95”, dhe më tej të vijohet me nenin 95 pika 5 dhe neni 115 dhe vijues të Kodit Zgjedhor.

**Znj. I. Nano:** Sapo edhe unë e konsultova me Kodin Zgjedhor dhe bashkohem me propozimin e zotit Çakaj. Pikërisht ky është një nga nenet autorizuese për nxjerrjen e këtij akti. Kështu që do të kërkoja kolegët të votonin për propozimin e zotit Çakaj.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Unë sapo kam lexuar tekstin e nenit 1. Lidhur me nenin 1, kolegë? Zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Faleminderit! Duke qenë se në këtë nen është i përcaktuar se cili është qëllimi i këtij vendimi, duke iu referuar edhe vetë titullit të tij, por edhe përmbajtjes është përcaktuar që ky akt pra ka të bëjë me organizimin e punës në Vendet e Numërimit të Votave, për organet e qeverisjes vendore, por, duke qenë se në nenin 1 është një dispozitë e përgjithshme ku nuk është përcaktuar se për cilat organe, pra për zgjedhjet për pushtetin qendror apo për organet e qeverisjes

*Zbardhi materialin audio,  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

vendore është përcaktuar ky akt, do të propozoja që në fund të fjalisë, pra pas togfjalëshit “për zonën e administrimit zgjedhor” të shtohet “për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Për nenin 1, a kemi ndonjë gjë tjetër? Kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çaka.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Neni 2. “Detyrat e grupit të numërimit të votave”. “1. Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor KZAZ organizon punën dhe garanton funksionimin korrekt të procesit të marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore të procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve për Zonën e Administrimit Zgjedhor. 2. Grupi i numërimit të votave GNV, nxjerr rezultatin e zgjedhjeve për çdo qendër votimi që numëron. 3. Grupi i numërimit të votave përbëhet nga 4 anëtarë, ku një nga anëtarët është numëruesi i parë. 4. Grupi i numërimit të votave funksionon minimalisht me 2 anëtarë. 5. Një grup numërimi numëron jo më pak se 5 dhe jo më shumë se 10 Qendra Votimi QV”. A keni ndonjë mendim për nenin 2? Po, zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë që neni 2 të kryejë ekzaktësisht qëllimin për të cilinë është vendosur në këtë draft, dhe, meqenëse detyrat e grupit të numërimit të votave janë të larmishme dhe, do të thosha, që ato ekspozohen në të gjithë aktin, do ta konsideroja të duhur nëse kjo dispozitë do të saktësohej që në titull dhe më pas në renditjen e pikave të saj. Ndaj unë propozoj që titulli të mos jetë “Detyrat e Grupit të Numërimit të Votave”, pasi nuk janë shtruese në mënyrën si janë ekspozuar këtu, ose shkruar, por do të sugjeroja dhe propozoja në të njëjtën kohë

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

që titulli i kësaj dispozitë te jetë “Grupi i Numërimit të Votave dhe funksionimi i tij”. Dhe më pas ne rendin e se çfarë përfaqëson grupi i numërimit të votave dhe ku dalin funksionet, pika 2 e kësaj dispozite, të bëhet pika 5, pra të ndryshojë vendet dhe të bëhet pika 5 dhe kështu merr kuptimin e asaj që përshkruan dhe titulli në të njëjtën kohë. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Pra, zonja Vukaj, propozon ndryshimin e titullit “Grupi i Numërimit të Votave dhe funksionimi i tij”. Dhe për hir të radhës së punëve pika 2 të shkojë pika 5, pika 3 bëhet 2, pika 4 bëhet 3 dhe kështu me radhë. Po. Zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Kam edhe unë një propozim. Atëherë pika ekzistuese numër 4, e propozuar nga Komisioneri është Grupi i Numërimit të Votave dhe funksionon minimalisht më 2 anëtarë. Në fakt, konstatojmë se kjo i referohet Kodit Zgjedhor, neni 95, pika 2 paragrafi i dytë, dhe bëhet fjalë për mënyrën si funksionon GNV-ja. Si rregull GNV-ja funksionon me 4 anëtarë, dhe vetëm në rast se nuk do të arrihet kuorumi minimumi i përcaktuar nga ligjvënësi do të ishte që GNV-ja do të funksionojë me jo më pak se dy anëtarë. Pra, kemi përjashtim nga rregulli. Në këto kushte, referuar edhe bazës ligjore të sipërcituar, unë propozoj që pika 4, pra aktualisht pika 4 të riformulohet: Si rregull GNV-ja funksionon me të gjithë anëtarët dhe në rast se nuk është i mundur plotësimi i kuoromit ajo funksionon me jo më pak se dy anëtarë.

**Znj. I. Nano:** Brenda propozimit tuaj, a mund të bëj një propozim? Meqenëse ju iu referuat te neni 95, sepse kuorumi dhe të gjithë anëtarët janë dy gjëra të ndryshme, në fakt, neni 95 thotë: “Në rast se nuk është i mundur plotësimi i numrit të anëtarëve të grupit të numërimit të votave ai funksionon me jo më pak

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

se dy anëtarë”. Pra, si rregull me 4 dhe 95, pika 3 fjalia e dytë të transpozohet , se po folëm për kourum jo domosdoshmërisht nënkupton të plotë numrin 4.

**Z. M. Çakaj:** Po ai është qëllimi. Pra, ideja është kjo që rregulli i përgjithshëm është që GNV-ja funksionon me 4 anëtarë. Në situata të ndryshme hipotetike nuk plotësohet numri 4 i anëtarëve, por mund të kemi 3, mund të kemi 2, në çdo rast, jo më pak se 2 anëtarë. Pra, minimumi që GNV-ja duhet të funksionojë do të jetë jo më pak se dy anëtarë. Pra, riformulimi do të ishte: “Si rregull GNV funksionon me të gjithë anëtarët dhe në rast se nuk është i mundur plotësimi ajo funksionon me jo më pak se dy anëtarë”.

**Znj. I. Nano:** Dakord. Për nenin 2 kemi 3 propozime. 1. Propozim i zonjës Vukaj për të ndryshuar titullin.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

2. Propozimi i zonjës Vukaj për të këmbyer pikën 2 me pikën 5, ose le të themi që pika 2 të jetë pika e fundit.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Propozimi i zotit Çakaj që pika 4 ekzistuese, dhe në varësi të renditjes mund të marrë një numër tjetër, të riformulohet për të siguruar përputhshmërinë me Kodin Zgjedhor më funksionimin e plotë dhe në rast pamundësie me jo më pak se dy anëtarë.

**Kush është dakord?**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Kalojmë te neni 3. “Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave.”  
“Teknologjia mbështetëse e numërimit të votave instalohet në çdo VNV. Çdo tavolinë numërimi është e pajisur me sistemin e teknologjisë mbështetëse përkatëse. 2. KZAZ-ja kujdeset për ruajtjen nga dëmtimet e jashtme të kësaj teknologjie nga momenti i fillimit të procesit të numërimit të votave në VNV dhe deri në nxjerrjen e rezultatit të zonës së administrimit zgjedhor. 3. Grupi i numërimit të votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamera sipas procedurave të parashikuara në këtë vendim. A keni ndonjë gjë për nenin 3, kolegë? Po, zoti Çela.

**Z. A. Çela:** kam një propozim sa i përket pikës 3 të nenit 3 për një ndryshim, “Grupi i Numërimit të Votave është përgjegjës për ekspozimin e çdo flete votimi në kamerë sipas procedurave të parashikuara në këtë vendim”. Unë propozoj që pjesa “përgjegjës për ekspozim” të ndryshohet në “ka detyrim të ekspozojë çdo fletëvotimi në kamerë” sipas procedurave të parashikuara në këtë vendim. Pra, për ta kthyer në detyrim.

**Znj. I. Nano:** Dakord. A keni ndonjë gjë tjetër për nenin 3? Kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çela.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Kreu 2. “Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor nga KZAZ-ja”. Neni 4 “Caktimi grupeve të marrjes në dorëzim”. Pika 1. “Për marrjen në dorëzim të

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

kutisë, kutive të votimit me fletët e votimit dhe të kutisë kutive me materialet e votimit nga KQV-të KZAZ-ja cakton një ose më shumë grupe të marrjes në dorëzim”. 2. “Grupet e marrjes në dorëzim përbëhen nga 2 anëtarë të KZA-së me përkatësi të ndryshme politike të propozuar përkatësisht nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së”. 3. “Nëse është e nevojshme KZAZ-ja cakton 2 persona në ndihmë për çdo grup të marrjes në dorëzim nga lista e anëtarëve të GNV-ve, të cilët merren kryesisht me sistemin e kutive nën drejtimin e KZAZ-së. Në caktimin e tyre duhet pasur parasysh përkatësia politike dhe baraspeshimi shumicë opozitë. Propozimet për caktimin e këtyre personave bëhen nga kryetari dhe zëvendëskryetari i KZAZ-së”. A keni diçka lidhur me nenin 4 “Caktimi i grupeve të marrjes në dorëzim”? Kalojmë në votimin e nenit 4.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 5. “Detyrat e grupit të marrjes në dorëzim”. 1. “Grupi i marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore caktohet dhe funksionon vetëm për marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore të sjella nga KQV-të në VNV”. 2. “Kutia, kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutia me materialet e votimit të çdo QV-je merren në dorëzim sapo ato mbërrijnë në VNV-të sipas rregullave të përcaktuara në këtë vendim”. 3. “Grupet e marrjes në dorëzim në asnjë rast nuk mund të refuzojnë marrjen në dorëzim të kutisë, kutive të votimit me fletët e votimit, të kutisë me materialet e votimit të çdo QV-je apo materialeve të tjera të logjistikës zgjedhore të cilat dorëzohen nga KQV-të në VNV”. Atëherë, kolegë, a keni diçka lidhur me nenin 5, nëse jo kalojmë në votim.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka***


***Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ***



***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 6. "Marrja në dorëzim e materialit zgjedhor". "Gjatë procesit të marrjes në dorëzim të materialit zgjedhor grupi i marrjes në dorëzim ndjek këtë procedurë:

a. Merr nga sekretari i KZAZ-së dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV. Kjo dosje përmban procesverbalin përkatës për pajisjen me vula, me kodet e sigurisë dhe modelin krahasues të vulës së kryetarit të KQV-së; b. Shënon në procesverbalin e marrjen në dorëzim numrat e kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia me materialet e votimit; I. Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë së vulave me të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit me numrat e kodeve të sigurisë së vulave të shënuara në procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë së vulave nga KZAZ-ja në KQV. Në rast mospërputhjeje të numrave të kodeve të sigurisë së vulave grupi i marrjes në dorëzim informon menjëherë KZAZ-në për mospërputhjen dhe i kërkon asaj që kutia të shënohet "Kuti e parregullt"; II. KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen e konstatuar nga grupi i marrjes në dorëzim dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë sipas shkronjës "f" të këtij neni; III. Mospërputhjet e konstatuara shënohen nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim dhe nga KZAZ-ja në librin e protokollit të mbledhjeve dhe procesverbalin e konstatimit. Me qenë se po shoh diçka po i kërkoj që gjatë zbardhjes të respektohet renditja, sepse i kemi "a", "b", "ç", "c", "dh", "d", "ë", "e" dhe të tjera me radhë dhe kjo edhe mund të na afektojë dhe referencën konkrete, por e diskutojmë. Unë po them "ç" siç është e shkruar, sepse nuk dimë nëse do të ketë propozime për ndryshime. Shkronja "ç": Verifikon nëse mungojnë ose janë këputur një ose më shumë vula me kode sigurie; c. Verifikon nëse vendosja e vulave me kodet e sigurisë është bërë në mënyrë në tillë që lejon hapësira midis trupit të kutisë dhe kapakut të saj; dh. Verifikon nëse kutia ka në trupin apo në kapakun e saj thyerje ose çarje që lejojnë futjen apo





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

nxjerrjen e fletëve të votimit apo materialit tjetër zgjedhor; d. Verifikon nëse kutia është e formës, llojit dhe përmasave të ndryshme nga ato të përcaktuara me vendimin e KQZ-së; ë. Në rast se grupi i marrjes në dorëzim gjatë marrjes në dorëzim të kutive me fletët e votimit dhe kutisë me materialet e votimit konstaton të paktën njërën nga parregullsitë e përcaktuara në shkronjat “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, të këtij neni, njofton menjëherë KZAZ-në dhe i kërkon asaj që kutia përkatëse të shënohet kuti e parregullt. KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë; e. KZAZ-ja kur konstaton parregullsitë sipas shkronjave “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” të këtij, neni vlerëson kutinë si të parregullt i vendos etiketën “Kuti e parregullt” dhe porosit menjëherë operatorin, ndihmësin teknik ta hedhë këtë fakt në sistemin elektronik; f. Të gjitha mospërputhjet apo parregullsitë e konstatuara për secilën kuti votimi me fletët e votimit ose për secilën kuti me materialet e votimit të deklaruara të parregullta shënohen nga KZAZ-ja në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit dhe nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim; gj. Grupi i marrjes në dorëzim plotëson procesverbalin e marrjes në dorëzim të materialeve zgjedhore nga KQV-ja përkatëse, sipas formularit tip të përgatitur nga KQZ-ja; g. Procesverbali i marrjes në dorëzim nënshkruhet nga anëtarët e grupit të marrjes në dorëzim, kryetari dhe sekretari i KQV-së dhe punonjësi i Policisë së Shtetit, i caktuar për shoqërimin e materialeve zgjedhore nga KQV-ja në VNV; h. origjinali i procesverbali të marrjes në dorëzim administrohet nga KZAZ-ja, kopje të tij i jepen kryetarit, sekretarit të KQV-së dhe punonjësit të Policisë së Shtetit, i cili largohet menjëherë më marrjen e kopjes së procesverbalit”. Është nen i gjatë, kështu që kolegë në se keni diçka? Po, zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Atëherë kam dy pyetje për administratën, të cilat në varësi të përgjigjes, besoj mund të reflektojnë edhe në ndryshime të vogla të aktit. Në

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

shkronjën “a” të këtij neni është përcaktuar që një nga dokumentet, që përmbante dosja, që merret nga ana e sekretarit të KZAZ-së është edhe procesverbali përkatës për pajisjen me vula dhe me kode të sigurisë. Ndërkohë nëse do t’i referohemi shkronjës “b” të këtij neni, pra në shkronjën “b” nënndarja I, thuhet: “Verifikon në çast përputhjen e numrave të kodeve të sigurisë me vula në të cilat janë mbyllur kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit me numrat e kodeve të sigurisë së vulave të shënuara në procesverbalin e dorëzimit të kodeve të sigurisë të vulave nga KZAZ-ja në KQV”. Pra, në shkronjën “a” kemi: “procesverbali i pajisjes me vula me kode sigurie”, ndërsa në nënndarjen II: “procesverbali i dorëzimit të kodeve të sigurisë së vulave”. Pyetja është: a kemi të bëjmë me të njëjtin procesverbal?


**Z. E. Meta: Po.**

**Z. D. Çaka:** Atëherë, besoj se ka nevojë për unifikimin e terminologjisë, sepse ndryshon. Besoj se mbase kjo nuk ka nevojë...

**Znj. I. Nano:** Jo, unifikimi terminologjisë është diçka që mund të reflektohet gjatë zbardhjes për të vendosur emërtimin e saktë.

**Z. D. Çaka:** Në shkronjën “b”, nënndarja II thuhet: “KZAZ-ja verifikon menjëherë mospërputhjen e konstatuar nga grupi i marrjes në dorëzim dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë sipas shkronjës “f” të këtij neni”. Nëse do të shkojmë te shkronja “f”, aty thuhet: “Të gjitha mospërputhjet ose parregullsitë e konstatuara për secilën kuti votimi me fletët e votimit, ose për secilën kuti me materialet e votimit të deklaruar shënohen nga KZAZ-ja në librin e protokolleve të mjeteve në procesverbalin e konstatimit dhe nga grupi i marrjes në dorëzim në procesverbalin e marrjes në dorëzim”. Kështu që unë mendoj se besoj se qëllimi

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

nuk është që të jetë ky normim, por, mbase duhet të jetë shkronja “ë” e vjetra ose “e” e reja në këtë citim që në rast se grupi i marrjes në dorëzim, gjatë marrjes në dorëzim të kutive të fletëve të votimit dhe kutive të materialeve të votimit konstaton të paktën një nga parregullsitë e përcaktuara në shkronja “c”, “ç”, “d”, “dh”, “e” të këtij neni njofton menjëherë KZAZ-në dhe i kërkon asaj që kutia përkatëse të shënohet kutia e parregullt. KZAZ-ja verifikon menjëherë parregullsinë dhe merr vendim për vlerësimin e kutisë. A jam i saktë? Pra, këtu në këtë pikë shkronja “f”, është “ë”-ja aktuale, por me renditjen e re duhet të bëhet “e”-ja.

**Znj. I. Nano:** Por do të bëhet rirenditja, sepse dhe do të keni parasysh gjatë zbardhjes këtu nuk është propozim për ndryshim, janë vetëm korrigjime të vogla, do të keni parasysh referencat që keni brenda nenit.

**Z. D. Çaka:** Edhe brenda nenit ku janë shkronjat: “g”, “f”, “ç”, “d”, “dh”, “e”, të shihen pas riformulimit.

*(Diskutim pa mikrofon)*

**Znj. I. Nano:** Këto diskutime të zotit Çaka, nuk përbëjnë propozim për ndryshim, por janë vetëm kërkesa për të harmonizuar terminologjinë e përdorur për të pasur parasysh më mirë referencat dhe për të rirenditur, sipas alfabetit të gjuhës shqipe, shkronjat. Atëherë, votojmë nenin 6.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Neni 7. “Kutitë e deklaruara “kuti e parregullt””. 1. “Në rastet kur për një qendër votimi gjatë marrjes në dorëzim të kutive të votimit dhe kutisë së materialeve të

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

votimit; a. të dy kutitë e votimit me fletët e votimit janë vlerësuar kuti e parregullt, atëherë kutitë me fletët e votimit dhe kutia përkatëse me materialet e votimit vendosen në këndin e kutive të parregullta; b. Kur vetëm njëra nga kutitë e votimit me fletët e votimit është vlerësuar “Kuti e parregullt”, atëherë vetëm ajo dërgohet në këndin e kutive të parregullta, ndërsa kutia tjetër e votimit dhe kutia e materialeve të votimit i nënshtrohet procedurave të numërimit sipas përcaktimeve të neneve 116 deri 119 të Kodit Zgjedhor; c. Kutitë me fletët e votimit janë marrë në dorëzim të rregullta dhe kutia e materialeve të votimit është vlerësuar nga KZAZ-ja “Kuti e parregullt” ajo i nënshtrohet procedurave të hapjes dhe vlerësimit së bashku me kutitë e votimit me fletët e votimit. Në çdo rast parregullsitë që kanë çuar në vlerësimin e kësaj kutie si kuti e parregullt shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve dhe në procesverbalin e konstatimit. 2 Kutitë e votimit të përcaktuara, si “Kuti e parregullt” në asnjë rast dhe për asnjë arsye nuk hapen nga KZAZ-ja dhe nuk i kalojnë GNV-ve për vlerësim. Këto kuti dërgohen në KQZ së bashku me kutinë e materialeve të votimit për nevoja të hetimit administrativ. 3. Kutitë me fletët e votimit, të vlerësuara si “Kuti e parregullt” vendosen në vendin e veçantë të caktuar nga KZAZ-ja për kutitë e parregullta së bashku me kutinë e materialeve të votimit të QV-s përkatëse. Bën përjashtim nga ky rregull rasti kur në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore kutia e materialeve të votimit shoqëron kutinë tjetër të votimit të asaj QV-je, e cila nuk është vlerësuar e parregullt. Për nenin 7, a keni ndonjë mendim? Po, zoti Çaka.

**Z. D. Çaka:** Kam një pyetje për administratën për pikën e tretë. Në fjalinë e fundit thuhet: “Bën përjashtim nga ky rregull rasti kur për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore kutia e materialeve të votimit shoqëron kutinë tjetër, votimi tek e cila është vlerësuar e parregullt”. Tani në kushtet kur ky akt është

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

posaçërisht për zgjedhjet në organet e qeverisjes vendore, pse ky përjashtim “në zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore”?

**Znj. I. Nano:** Pjesa e parë e dispozitës i referohet zgjedhjeve për Kuvendin?

**Z. E. Meta:** Është dispozitë e përgjithshme dhe për këtë arsye ka qenë e specifikuar.

**Znj. I. Nano:** Që do të thotë se në këtë akt, që është i dedikuar për organet e qeverisjes vendore, ky përjashtimi është rregull?

**Z. E. Meta:** Po.

**Znj. I. Nano:** Fjalja e parë nuk qëndron. Atëherë, do të ishte më mirë të riformulohej: “Në zgjedhjet për organet e qeverisej vendore kutia e materialeve të votimit shoqëron kutinë tjetër të votimit të asaj QV-je, e cila nuk është vlerësuar e rregullt”. Kërkohej një reformulim nga ana e administratës.

**Z. E. Meta:** Pra, kutia e materialeve të votimit shoqëron kutinë tjetër të votimit të qendrës së votimit, e cila nuk është vlerësuar e parregullt.

**Znj. I. Nano:** Pra, ai që është përjashtim, tashmë është rregull. Kolegë, e votojmë këtë ndryshim, pra, nenin 7 me këtë ndryshim në pikën 3.


**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

**Me 5 vota pro, miratohet.**

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

Neni 8. “Sistemimi i kutive me fletët e votimit dhe kutive me materialet e votimit në VNV.” 1. KZAZ-ja cakton paraprakisht vendin ku do të vendosen kutitë me fletët e votimit dhe kutitë me materiale të votimit, para numërimit dhe pas numërimit sipas planvendosjes orientuese bashkëlidhur vendimit nr. 3 datë 09.02.2021 të Komisionit Rregullator për kriteret e caktimit dhe organizimit të vendit të numërimit të votave, si dhe një hapësirë për kutitë e vlerësuara kuti e parregullt. 2. Sapo kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë me materialet e votimit janë marrë në dorëzim nga grupet e marrjes në dorëzim, ato vendosen në vendin e përcaktuar paraprakisht nga KZAZ-ja, brenda të njëjtit mjedis ku kryhet numërimi i votave, i cili duhet të jetë i garantuar nga çdo ndërhyrje e personave të paautorizuar. Ky proces mbikëqyret nga KZAZ-ja. 3. Kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit renditen sipas numrit të qendrës së votimit. Qendrat e votimit renditen sipas rendit rritës të tyre, e para në radhë duhet të jetë QV-ja, me numër rendor më të vogël, dhe e fundit QV-ja me numër rendor më të madh. QV-të bija vendosen menjëherë pas QV-së mëmë. 4. KZAZ-ja i vendos kutitë e votimit të grupuara sipas organit përkatës. Fillimisht rendit në rend rritës, kutitë e votimit për kryetarin e bashkisë, në rreshtin e dytë rendit në rend rritës kutitë e votimit për këshillin e bashkisë dhe në rreshtin e tretë rendit kutitë me materialet e votimit. Në këtë renditje kutitë e votimit dhe kutia e materialeve të votimit të çdo QV-je janë përbri njëra –tjetrës. Për nenin 8 kemi diçka kolegë? Jo? Kalojmë në votimin e nenit 8.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Kreu 3. “Fillimi i procesit të numërimit” Neni 9. “Personat e pranishëm në VNV.1.” Gjatë procesit të numërimit të votave në VNV janë të pranishëm vetëm:  
a) anëtarët dhe sekretari i KZAZ-së; b) anëtarët e grupeve të numërimit të votave

***Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ***





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

të caktuar me vendim të KZAZ-së; c) përfaqësuesit e akredituar të medias; ç) vëzhguesit e subjekteve zgjedhore; d) vëzhguesit e tjerë të akredituar; dh) kandidatët dhe operatorët e teknologjisë mbështetëse të numërimit të votave; e) personeli teknik për mbarëvajtjen e sistemit të kamerave; f) stafi i KQZ-së i pajisur me autorizim të posaçëm nga KQZ-ja. 2. Të gjithë personat e pranishëm në VNV duhet të jenë të pajisur me një dokument identifikimi për të verifikuar identitetin e tyre. Personat e përmendur në shkronjat c, ç, d, dh, ë dhe f, të pikës 1 të këtij neni, duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin përkatës, akreditim apo autorizim sipas rastit nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve apo komisioni i zonës së administrimit zgjedhor. 4. KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin në VNV të personave të tjerë përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Po, zonja Vukaj.

**Znj. H. Vukaj:** Atëherë, në lexim të kësaj dispozite të propozuar nga administrata, pra, nga Komisioneri Shtetëror, mendoj se duhet të shkojnë në sinkron të lejitimit që ka bërë në pikën 1. Kufizimi dhe rregulli që vendos ligjvënësi në Kodin Zgjedhor, në nenin 121, pika 2, fjalia 2 ku thuhet se: në rast se personat jashtë kësaj liste të targëtuar dhe të lejuar për të qenë, kategorikisht nuk lejohen, dhe për këtë ka një procedurë ekstra të cilën mendoj që t'ia shtojmë pikës 4, edhe si transpozim saktësor i fjalisë së dytë, të pikës 2, duke thënë: “KZAZ-ja merr masa dhe është përgjegjëse për moslejimin në VNV të personave të tjerë përveç atyre të parashikuara në pikën 1 të këtij neni”. Në rast të pranisë së personave të tjerë KZAZ-ja me vendim njofton menjëherë punonjësën e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë edhe orën e saktë të ardhjes dhe të largimit të punonjësit të Policisë së Shtetit. Ju e dini shumë mirë, të nderuar kolegë, apo ju si administratë, që njihni dhe veprimtarinë apo eksperiencat në terren, që zakonisht si në qendrat e votimit, ashtu edhe në vendet e numërimit të votave ka tendencë për të qenë prezent

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

persona të paautorizuar. Kështu që le ta plotësojmë këtë pikë, që të jemi më korrektë, me dispozitën e Kodit Zgjedhor. Faleminderit!

**Znj. I. Nano:** Të them dhe unë diçka të vogël, për të sqaruar më tepër dhe pastaj në varësi të sqarimit të shohim nëse mund të arrijmë në një propozim. Në pikën 1 janë listuar personat që lejohen të jenë në vendin e numërimit të votave. Ndërkohë në pikën 3 themi që personat e përmendur në shkronjat c, ç, d, dh, e, ë dhe f, që do të thotë përfaqësuesit e akredituar të medieeve, vëzhguesit e subjekteve, vëzhguesit e tjerë të akredituar, kandidatët, operatorët, personeli teknik dhe f, stafi i KQZ –së, duhet të jenë të pajisur me dokumentacionin përkatës akreditim apo autorizim sipas rastit. Në rastin e kandidatëve autorizim nga kush, akreditim nga kush? Mos duhet vërtetim, vendimi i regjistrimit? Kush ia jep vërtetimin kandidatit, që është kandidat?

*(Diskutim pa mikrofon)*

Pra, të themi akreditim, autorizim apo vërtetim sipas rastit, se të paktën në rastin e kandidatit kërkohet vërtetim, s'ka as autorizim, as akreditim. Atëherë kemi 2 propozime. Në pikën 3, po i marr me radhë sipas pikave jo sipas rendit që u bënë propozimet. Në pikën 3, të shtohet: akreditim, autorizim apo vërtetim, sipas rastit. Votojmë këtë kolegë?

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Është propozimi i zonjës Vukaj për pikën 4, për një shtesë duke tranzpozuar fjalinë e dytë të pikës 2 të nenit 121 të Kodit Zgjedhor: “Në rast të pranisë së personave të tjerë përveç atyre sipas pikës 1 të këtij neni, KZAZ-ja me vendim njofton menjëherë punonjësin e Policisë së Shtetit dhe rasti mbahet shënim në

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, duke përfshirë dhe orën e saktë të ardhjes dhe të largimit të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

***Kush është dakord?***


***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Kalojmë te neni 10. “Veprime paraprake të KZAZ-së” KZAZ –ja pasi sigurohet se janë marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit dhe pasi është siguruar që të gjithë anëtarët e GNV-ve kanë marrë trajnimin e nevojshëm, merr masa paraprake për fillimin e procesit të numërimit të votave si më poshtë: a) sigurohet që vendi i numërimit të votave është gati për fillimin e procesit të numërimit të votave; b) sigurohet që anëtarët e grupeve të numërimit janë prezent në VNV dhe janë ulur në tavolinat përkatëse të numërimit; c) grupimet e numërimit janë të pajisura me materiale të nevojshme logjistike për procesin e numërimit të votave; ç) verifikon që të pranishëm në VNV janë vetëm personat e parashikuar në nenin 9 të këtij vendimi; d) sigurohet se është kryer mbyllja e kutive të posaçme për fletët e votimit të hedhura gabim, sipas procedurave të mbylljes së kutive të votimit të përcaktuara në Kodin Zgjedhor; dh) merr konfirmimin nga operatori teknik për funksionimin normal të teknologjisë mbështeste dhe numërimit të votave. Kemi diçka për nenin 10? Për pikën d? E para, unë do të propozoja një shtesë të vogël, kur flasim për kutitë e posaçme, për fletët e votimit të hedhura gabim, do të thosha: dedikuar për fletët e votimit të hedhura gabim të mos krijohet ndonjë konfuzion dhe para se të fillonim mbledhjen, zoti Çaka donte të pyeste lidhur me mbylljen e kutive të posaçme, si është procedura.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

**Z. D. Çaka:** Atëherë, këto kuti të posaçme do të mbyllen në fazën paraprake të punës së KZAZ-së, apo në momentin mbasi grupet e numërimit kanë përfunduar dhe do të bëhet, po themi, futja e zarfeve ose e fletëve të votimit që janë hedhur gabim?

**Z. E. Meta:** Kutitë e posaçme trajtohen njësoj si kutitë e votimit në qendrat e votimit. Pra, ndiqet e njëjta procedurë, që në momentin e parë, mbyllet me 4 vula kode sigurie dhe kodi 5 mbyllet në përfundim të përfundimit të procesit, pra të ...

**Znj. I. Nano:** Mirë, atëherë kemi vetëm një shtesë fjalën: dedikuar për fletët e votimit të hedhura gabim.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Kalojmë në nenin 11. "Fillimi i procesit të numërimit të votave" KZAZ-ja merr vendim për fillimin e procesit të numërimit të votave pasi ka marrë në dorëzim të gjitha kutitë e votimit me fletët e votimit dhe kutitë e materialeve të votimit nga të gjitha QV-të në juridiksionin e saj. Në vendimin për fillimin e numërimit të votave shënohet ora e saktë e fillimit të procesit të numërimit të votave. Kryerja e proceduarve për veprimet paraprake të përcaktuara në nenin 10 dhe ora e fillimit të procesit të numërimit të votave shënohen në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së. 2. Kutitë e votimit në fletët e votimit të pranuar si të rregullta, në çdo rast u nënshtrohen procedurave të hapjes dhe të numërimit në VNV, sipas procedurave të këtij vendimi. 3. Procesi i numërimit vazhdon në mënyrë të pandërprerë deri në numërimin e të gjithë kutive të pranuar të rregullta nga ana e KZAZ-së. Procesi i numërimit ndërpritet me vendim të KZAZ-së vetëm për shkaqe që nuk varen nga administrata zgjedhore dhe që pengojnë procesin normal

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

të numërimit. Shkaqet argumentohen në librin e protokollit të mbledhjeve të KZAZ-së, përfshirë edhe vendimin për rifillimin e numërimit. 4. Refuzimi për të numëruar sjell shkarkimin e menjëhershëm të personave të ngarkuar për numërimin, ose sipas rastit KZAZ-së. 5. Refuzimi për të numëruar kutinë e pranuar si të rregullt përbën vepër penale dhe ndëshkohet sipas nenit 330/a të Kodit Penal. Atëherë për nenin 11, kolegë kemi diçka? Jo, kalojmë në votimin e nenit 11.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 12. "Radha e numërimit" 1. Numërimi fillon me vota për kryetarin e bashkisë dhe më pas vijon me numërimin e votave për këshillin e bashkisë. 2. Numërimi i votave për këshillin e bashkisë fillon vetëm pasi ka mbaruar numërimi votave për kryetarin e bashkisë. Keni diçka? Kalojmë në votim?

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, zgj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet neni 12.***

Neni 12. Kreu 4. "Procedurat që ndiqen për numërimin e votave nga grupi i numërimit të votave" Neni 13. "Veprimet paraprake të GNV –së" 1. Sekretari i grupit të numërimit ndjek procedurën si më poshtë: a) nën kujdesin e një anëtari të ngarkuar nga KZAZ-ja merr me radhë, sipas numrit rendor rritës të qendrave të votimit, kutinë e votimit me fletët e votimit të vetëm një qendre votimi dhe e vendos atë pranë tavolinës së grupit të numërimit; b) sekretari i GNV-së për çdo qendër votimi vendos, ngjit në tavolinën e përcaktuar nga KZAZ-ja, etiketën adezive dhe shkruan numrin e qendrës së votimit që numërohet; c) merr nga sekretari i KZAZ-së dosjen e KQV-së përkatëse, e cila është plotësuar gjatë

***Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

dhënies së bazës materiale zgjedhore nga KZAZ-ja në KQV. Në dosje ndodhet procesverbali përkatës për pajisjen me vula, me kode të sigurisë së KQV-së dhe modeli krahasues i vulës së kryetarit të KQV-së. Lidhur me nenin 13, kemi diçka kolegë? Jo, kalojmë në votimin e nenit të 13.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 14. "Numërimi i votave" 1. Numëruesi i parë vendos mbi tryezë kutinë e votimit me fletët e votimit dhe ekspozon në kamera për jo më pak se 2 sekonda në faqen anësore, ku është vendosur etika me numrin e qendrës së votimit, e hap atë duke këputur vulat me kodet e sigurisë dhe nxjerr nga kutia e votimit procesverbalin e mbylljes së votimit. 2. Fillimisht grupi i numërimit të votave kryen procedurën e verifikimit të të dhënave në procesverbalin e mbylljes së votimit. 3. Në rast se procesverbali i mbylljes së votimit gjendet në kutinë e votimit dhe të gjitha rubrikat e tij janë plotësuar sipas nenit 113 të Kodit Zgjedhor, atëherë numërimi vazhdon sipas proceduarve të përcaktuara nga ky nen. Në të kundërt KZAZ-ja plotëson procesverbalin e konstatimit dhe GNV-ja vepron sipas përcaktimeve të nenit 16 të këtij vendimi. 4. Pas nxjerrjes së procesverbalit të mbylljes së votimit, numëruesi i parë dhe anëtarët e grupit të numërimit nxjerrin nga kutia fletët e votimit dhe zarfin me procesverbalin e vulosjes, i shpalosin fletët e votimit dhe i vendosin mbi tryezë me pjesën e pasme të fletës nga ana e sipërme. Kur gjatë këtij procesi konstatohen fletë votimi që i përkasin organit tjetër, për të cilën është votuar, GNV-ja i la ato mënjanë të palosuara dhe pa bërë vlerësim. Në përfundim të numërimit të kutisë këto fletë futen në zarfin me shënimin: "vota hedhura gabim", të ndara në zarfe të veçanta sipas llojit të organit për të cilin janë hedhur. 6. Fletët e votimit të shpalosura dhe të stivuara numërohen nga numëruesi i parë, i cili në përfundim të numërimit ua bën të ditur shifrën anëtarëve të grupit

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

dhe vëzhguesve të subjekteve zgjedhore. 7. Shifra e deklaruar së bashku me shifrën e votave të hedhura gabim, kur ka të tilla, verifikohet me shifrën për pjesëmarrjen e zgjedhësve të shënuar në procesverbalin për mbylljen e votimit. Nëse shifrat nuk përputhen ose nëse kërkohet nga ndonjë prej anëtarëve të grupit të numërimit, numëruesi i parë është i detyruar të rifillojë edhe një herë numërimin e fletëve të votimit. Në rast se nga verifikimet e kryera konstatohen mospërputhje, atëherë GNV-ja ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore që bën konstatimin, njofton menjëherë KZAZ –në për mospërputhje. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së deri sa KZAZ –ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë. Në rast se KZAZ-ja konfirmon pasaktësinë, e pasqyron atë në procesverbalin e konstatimit. KZAZ-ja vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në procesverbalin e konstatimit, merr vendim për vazhdimin e procedurave të numërimit të votave nga GNV-ja dhe ia bën vendimin menjëherë të ditur GNV-së. Për nenin 14, kolegë, ka ndonjë gjë? Mirë kalojmë në votimin e nenit 14?

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 15. “Rastet kur hapet kutia e materialeve të votimit” 1. Kutia e materialeve të votimit hapet gjatë procesit të numërimit të votave në VNV vetëm në rastet kur procesverbali i mbylljes së votimit mungon në kutinë e votimit me fletët e votimit ose nuk janë plotësuar të dhënat, sipas përcaktimeve të nenit 113 të Kodit Zgjedhor. 2. Grupi i numërimit ose cilido nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, që bën konstatim, njofton menjëherë KZAZ-në për problemin. Njoftimi bëhet me ngritjen e dorës dhe pa lëvizur nga vendi. Ngritja e dorës pezullon çdo veprim të mëtejshëm të GNV-së deri sa KZAZ-ja të njihet me çështjen dhe ta verifikojë atë.

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

Në rast se KZAZ-ja konfirmon mungesën e procesverbalit të mbylljes së votimit në kutinë e votimit, pasaktësi ose parregullsi në plotësimin e tij, pasqyron fakte në procesverbalin e konstatimit. Vetëm pas regjistrimit të pasaktësisë ose parregullsisë në procesverbalin e konstatimit, KZAZ-ja merr vendim për vazhdimin e proceduarve të verifikimit të materialit të votimit dhe pezullimin e numërimit të votave nga grupi i numërimit. Vendimi i marrë nga KZAZ-ja i bëhet i ditur menjëherë GNV-së. 5. Pas njohjes me vendimin e KZAZ-së numëruesi i parë vendos kutinë me fletët e votimit, numërimi i të cilës është pezulluar, pranë tavolinës së numërimit dhe merr kutinë e materialeve të votimit të qendrës përkatëse. Kemi diçka për nenin 15, kolegë? Jo. Kalojmë në votimin e nenit 15.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 16. “Hapja e kutisë së materialeve të votimit, procedurat dhe radha e veprimeve të GNV-së”, që është gjithashtu një nen i gjatë. Kolegë, ta lexojmë të gjithë nenin?

*(Diskutim pa mikrofon)*

Atëherë, meqë është nen gjatë, është 2 faqe 1 nen, hapja e kutisë së materialeve, procedura dhe radha e veprimeve të GNV –së, personalisht do të doja nga ana e administratës prapë një unifikim terminologjie në pikën 5, shkronja “a” nëndarja 4/i dhe nëndarja 11/i, thjesht për të parë terminologjinë e miratuar në aktet pararendëse. Raporti i mbylljes së identifikimit elektronik të zgjedhësve, raporti i hapjes së PEI-t, thjesht për ta unifikuar terminologjinë. Propozime për ndryshime nuk kemi, kështu që kalojmë në votimin e nenit 16.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 17. “Llojet e votave dhe kriteret e vlerësimit të votave” 1. Fletët e votimit të vlerësuar nga grupi numërimit ndahen në vota të vlefshme dhe vota të pavlefshme. Votat e pavlefshme të parashikuara në nenin 117, pika 2 e Kodit Zgjedhor janë vetëm fletët e votimit për kryetar bashkie, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie; b) fletët e votimit për këshillin e bashkisë në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore; 3. Vota të pavlefshme janë fletët e votimit kur: a) fleta e votimit nuk ka të njëjtën madhësi ngjyre ose formë me fletën e votimit miratuar nga KQZ-ja, b) fletës së votimit i mungojnë vulat e parashikuara në nenin 103 të Kodit Zgjedhor; c) në fletën e votimit janë bërë shënime apo shenja që e bëjnë të pamundur vlerësimin e votës; d) në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë janë bërë shënime në favor ose në disfavor të kandidatit, kandidatëve për kryetar bashkie, në fletën e votimit për këshillin e bashkisë janë bërë shënime në favor ose në disfavor të subjekteve të caktuara zgjedhore, f) në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë është votuar për më shumë se 1 nga kandidatët për kryetar bashkie. Në fletën e votimit për këshillin e bashkisë është votuar për më shumë se një nga subjektet zgjedhore. Nuk është votuar për asnjë nga subjektet zgjedhore, kandidatët për kryetar bashkie në fletën e votimit, nuk është e qartë se për kë është votuar ose zgjedhësi ka votuar për një person apo subjekt që nuk është në fletën e votimit. 4. Grupi i numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë, sa të jetë e mundur qëllimin e zgjedhësit. Atëherë për nenin 17, në fakt, janë të qarta dhe në Kodin Zgjedhor kriteret për votat e vlefshme edhe të pavlefshme. Kolegë, nëse s’kemi diçka, kalojmë në votimin e nenit 17.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

Neni 18. "Vlerësimi i votave" 1. Fletët e votimit të vlerësuara nga grupi i numërimit ndahen në vota të vlefshme, vota të pavlefshme dhe në fletë votimi të kontestuara. 2. GNV-ja bën ndarjen e hapësirës së tavolinës së numërimit, duke përcaktuar vendet e veçanta për fletët e votimit të vlefshme, të pavlefshme, të kontestuara. Në hapësirën e tavolinës së numërimit të caktuar për votat e vlefshme, GNV-ja përcakton vende të veçanta për grupime të fletëve të votimit të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor. 3. Numëruesi i parë i grupit të numërimit hap në mënyrë të plotë çdo fletë votimi, i vendos një nga një fletët e votimit dhe kamerën regjistruese, fillimisht nga faqja e pasme jo më pak se tre sekonda në mënyrë që të shihen qartë në monitor vula e KQV-së dhe vula e kryetarit të KQV-së. Gjatë shfaqjes së fletës së votimit nga faqja e pasme numëruesi i parë numëron dhe e deklaron të pavlefshme nëse fleta e votimit: a) nuk ka të njëjtën madhësi, formë dhe ngjyrë me fletën e votimit të miratuar nga KQZ-ja; b) nuk është e vulosur me vulën e KQV-së dhe me vulën e kryetarit të KQV-së; c) në fletën e votimit janë bërë shënime, shenja apo nënshkrime që bëjnë të mundur identifikimin e zgjedhësit. Gjatë kryerjes së kësaj procedure numëruesi i parë shprehet me zë të lartë vetëm për fletët e votimit të cilat i konsideron të pavlefshme gjatë vlerësimit nga faqja e pasme. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose ndonjë prej vëzhguesve të subjekteve zgjedhore, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin të caktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Kjo fletë votimi do të vlerësohet përsëri nga grupi i numërimit në momentin e rivlerësimit të votave. Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure për fletën e votimit të vlerësuar e pavlefshme, nuk ka pasur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për fletët e votimit të kontestuara dhe vijon me fletën tjetër të votimit. Kjo fletë votimi do të vlerësohet përsëri nga grupi i numërimit në momentin e rivlerësimit të votave. Në rast se gjatë kryerjes së kësaj procedure për fletën e votimit të vlerësuar e pavlefshme,

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

nuk ka pasur kontestime, atëherë ajo vendoset në vendin e caktuar për votat e pavlefshme mbi tavolinën e punës së GNV-së. 7. Vlerësimi i votave fillon menjëherë pas vlerësimit të fletës së votimit nga ana e pasme. 8. Grupi i numërimit për vlerësimin e çdo vote synon të identifikojë, sa të jetë e mundur, qëllimin e zgjedhësit për subjektin zgjedhor. 9. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat nuk ka asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 17, pika 3 të këtij vendimi dhe është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore në fletën e votimit për këshillin e bashkisë ose për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie në fletën e votimit për kryetarin e bashkisë. 10. GNV-ja vlerëson shprehjen e vullnetit të votuesit duke iu referuar, por pa u kufizuar në modelet ilustruese bashkëlidhur këtij vendimi. 11. Në rast se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e pavlefshmërisë së votës të parashikuara nga shkronjat “c” deri “j” të nenit 17, pika 3 të këtij vendimi dhe është votuar qartësisht vetëm për njërin nga kandidatët për kryetar bashkie, apo është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore për këshillin e bashkisë, numëruesi i parë çmon dhe pastaj u propozon për vlerësim anëtarëve të tjerë se për cilin kandidat për kryetar bashkie, subjekt zgjedhor është hedhur vota. 12. Numëruesi i parë gjatë kryerjes së kësaj procedure është i detyruar t’ua tregojë çdo fletë votimi anëtarëve të grupit të numërimit dhe të vendosë çdo fletë votimi në kamerën regjistruese jo më pak se 4 sekonda, në mënyrë që të shihet qartësisht në monitor shenja e cila tregon vullnetin e zgjedhësit. 13. Gjatë shfaqjes së fletës së votimit në kamerën regjistruese, numëruesi i parë i grupit të numërimit bën vlerësimin e votës me zë të lartë. 14. Në rast se anëtarët e grupit të numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore në numërim janë dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, fleta e votimit ndahet sipas vlerësimit dhe vendoset në vendin e caktuar për subjektin zgjedhor për të cilin është votuar. Numëruesi i parë e merr fletën tjetër të votimit dhe ndjek të njëjtën procedurë. Atëherë unë në këtë nen kam diçka vetëm në pikën 2, në fund të fjalisë. GNV-ja përcakton vende të veçanta për grupime të fletëve të

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

votimit, të vlefshme për çdo subjekt zgjedhor. Unë do të shtoja edhe kandidatë, dhe kandidatë edhe subjekt zgjedhor. Pa dyshim që kandidati është subjekt zgjedhor, por në hartimin e këtij akti dhe të akteve të tjera, me subjekt zgjedhor është konsideruar partia politike apo koalicioni që garojnë për këshillat bashkiakë apo qoftë edhe kandidati i propozuar për zgjedhësit për këshillat bashkiakë. Kemi propozime të tjera për nenin 18? Zoti Çakaj.

**Z. M. Çakaj:** Faleminderit, e nderuar! Atëherë duke qenë se tashmë edhe detyrim i Kodit Zgjedhor në nenin 94, pika 4, pra përcaktimi se çdo fletë votimi do të duhet t'i nënshtrohet regjimit të shfaqjes në monitor dhe në këtë mënyrë, edhe në kuadër të transparencës, po edhe në kuadër të informacionit, të cilin e kanë vetëm anëtarët e grupit të numërimit të votave dhe do të duhet ta kenë nëpërmjet shfaqjes së fletës së votimit në kamera dhe më pas pasqyrimin në monitor, do të duhet ta kenë edhe vëzhguesit, por edhe kandidatët për subjektet zgjedhore apo përfaqësuesit e ndryshëm, të cilët janë të akredituar apo janë prezent në VNV. Unë sugjeroj, më saktë, propozoj që në pikën 12 pas formulimit, siç është propozuar nga administrata, të shtohet edhe një parashikim i tillë. Pra, në rast se për një arsye ose për një tjetër, në rast se numëruesi i parë, ndoshta nga pakujdesia, ose ndoshta me keqdashje, nuk e shfaq fletën e votimit në kamerën e regjistrimit, atëherë në këtë rast do të ndërhyjë KZAZ-ja, e cila e detyron numëruesin e parë ta kryejë këtë procedurë, që jo pa qëllim ligjvënësi e ka parashikuar në Kodin Zgjedhor. Propozimi im konkret është ky: në rast se numëruesi i parë nuk shfaq në ekran një fletë votimi dhe kur ky veprim kontestohet nga anëtarët e GNV-së ose nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, KZAZ-ja detyron GNV-në të shfaqë në kamera fletën e votimit. Në kamerat regjistruese të tavolinës, në fakt, ajo kamera edhe regjistron, por është kamera edhe shfaqet drejtpërdrejt online, që pasqyron në monitor...

*Zbardhi materialin audio  
Mirgjina LEKAJ*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

**Znj. I. Nano:** Të jemi të qartë se për cilën kamera. Atëherë kemi dy propozime: në pikën 2 në fund të fjalisë të shtohet: “fletët e vlefshme për çdo kandidat/subjekt zgjedhor”.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Në pikën 12 kemi propozimin e zotit Çakaj, me përmbajtjen që ai sapo e lexoi, në rast se numëruesi i parë nuk e vendos një fletë votimi në kamera regjistruese dhe ky veprim kontestohet nga anëtarët tjerë të grupit të numërimit dhe vëzhguesit e subjekteve zgjedhore, ose nga vëzhguesit e subjekteve zgjedhore KZAZ-ja detyron GNV-në të shfaqë numëruesin...?

**Z. M. Çakaj:** Atëherë KZAZ detyron GNV-në të shfaqë në kamera...

**Znj. I. Nano:** Këtë fletë votimi.

**Z. M. Çakaj:** Fletën e votimit... Këtë fletë votimi, të cilën nuk e ka shfaqur.

**Znj. I. Nano:** Dakord! Mirë, atëherë votojmë propozimin e zotit Çakaj. Kush është dakord?

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S’ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Jemi tek neni 19, kontestimi dhe rivlerësimi i votës.

1. Në rast se ndonjëri nga anëtarët e grupit të numërimit ose vëzhguesit e tavolinës së numërimit përkatëse, nuk është dakord me vlerësimin e numëruesit të parë, ky

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*





*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

i fundit e vendos fletën e votimit të kundërshtuar në vendin e përcaktuar për fletët e votimit të kontestuara, dhe vijon me fletën tjetër të votimit.

2. Kontestimi i votës bëhet duke ngritur dorën dhe duke thënë: “Nuk jam dakord!”

3. Në përfundim të numërimit të fletëve të votimit të kutisë përkatëse të votimit, grupi i numërimit rivlerëson fletët e votimit të kontestuara.

4. Rivlerësimi bëhet nga grupi i numërimit dhe nuk i nënshtrohet procesit të shfaqjes së fletëve të votimit të kontestuara në kamera.

5. Gjatë procesit të rivlerësimit, vëzhguesit e subjekteve zgjedhore nuk kanë të drejtë të kontestojnë vlerësimin e votës dhe as të kërkojnë rishfaqjen e votave në monitor. Në çdo rast, vëzhguesit informohen për përfundimin e rivlerësimit. Në rast se, edhe pas rivlerësimit nga GNV-ja, ka fletë votimi të kontestuara nga të paktën një anëtar i GNV-së, atëherë GNV-ja thërret KZAZ-në për vlerësimin e votave të kontestuara të asaj kutie. KZAZ-ja, bën në çast vlerësimin e secilës fletë votimi të kontestuar, dhe merr vendim në lidhje me të, duke e vlerësuar atë votë të vlefshme, apo votë të pavlefshme. Rezultati i shpallur nga KZAZ-ja shënohet në librin e protokollit të KZAZ-së, dhe përfshihet në tabelën përkatëse të rezultatit të qendrës së votimit që harton grupi i numërimit të votave.

8. Për secilën fletë të kontestuar, numëruesi i parë i grupit të numërimit, shënon në pjesën e pasme të saj arsyet e kontestimit. Nr. i përgjithshëm i fletëve të votimit të kontestuara për QV-të përkatëse shënohet nga GNV në procesverbalin përkatës miratuar me vendim të KQZ-së.

9. Në përfund të nxjerrjes së rezultatit për QV-të përkatëse, fletët e votimit të cilësuar si të kontestuara dhe procesverbali përkatës futen në zarfin e fletëve të votimit të kontestuara.

Për nenin 19 kemi diçka? Jo. Votojmë nenin 19.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S’ka.***

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Me 5 vota pro miratohet.*

Neni 20, numërimi i votave të subjekteve zgjedhore. Pas numërimit dhe vlerësimit të votave për çdo kuti votimi...

*Z. M. Çakaj:* Më fal.

*Znj. I. Nano* Po!

*Z. M. Çakaj:* Atëherë, e nderuar, mesa shohim deri në nenin 20, kemi miratuar procedurën, pra rregullat dhe procedurën e numërimit të votave për kandidatë për kryetar bashkie dhe neni 20, fillon procesi i numërimit të votave për subjektet zgjedhore. Unë propozoj që të paktën, neni 20 dhe me pas edhe për ekonomi të kohës nëse janë dakord të gjithë anëtarët të lexojmë vetëm titujt dhe nëse nuk kemi vërejtje, propozime apo sugjerime ta miratojmë, por konkretisht për nenin 20 unë propozoj që të riformulohet në mënyrë të tillë që të ndiqet i njëjti standard, pra, për procesin e numërimit të votave për subjektet zgjedhor, GNV, ndjek të njëjtën procedurë dhe të njëjtat rregulla, si për procesin e numërimit të votave për kandidatët për kryetar bashkie dhe besoj me këtë e kemi ezauruar dhe gjithçka ça miratuam.

*Znj. I. Nano* Atëherë propozimi i z. Çakaj është që neni 20 të riformulohet, pra të mos ketë të gjitha këto procese, por vetëm me një fjali.

*Z. M. Çakaj:* Po. Të ndiqet e njëjta procedurë dhe i njëjti proces, nëse nuk ka ndonjë aspekt të veçantë..

*Znj. I. Nano:* Po, ka ndonjë aspekt të veçantë? Po!



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

**Z. E. Meta:** Pra, në përfundim të procesit të vlerësimit, bëhet numërimi i votave, siç parashikohet edhe neni 120 i Kodit Zgjedhor, ku përcaktohet, d.m.th, kuota e vlefshme...

**Z. M. Çakaj:** Po pra, i njëjti proces është, nuk është se ka diferencë apo aspekte të veçanta të cilat do të duhet t'i miratojmë rregulla apo procedura. Është i njëjti proces.

**Z. E. Meta:** Çështja qëndron që procedura për kryetarin e bashkisë, pra numri i votave, vlerësimi i numrit të votave për kryetarin e bashkisë, fillon dhe përfundon deri në tabulimin e rezultatit për atë QV.

**Z. M. Çakaj:** Po dakord, dakord, të pasqyrohen, të përfshihen të gjitha ato, por procedura dhe rregullat që ndiqen për numërimin e votave, dhe radha e punës të jetë e njëjta.

**Znj. I. Nano:** Ka ndonjë diçka, para se ta kalojmë në votim. Nga administrata, ndonjë merak?

**Z. M. Çakaj:** Se edhe nëse ka diçka nuk është se është shprehur këtu. Neni 20 thjesht, nuk është se shikoj ndonjë gjë që bie ndesh me çfarë miratuam deri tani.

**Znj. I. Nano:** Ka diçka?

**Z. E. Meta:** Jo!

**Znj. I. Nano:** Dakord, kalojmë në votimin e propozimit të zotit Çakaj për riformulimin e nenit 20.

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 21. Nxjerrja e rezultatit të zgjedhjeve nga grupi i numërimit për qendrën e votimit. Në përfundim të procedurave të numërimit...Doni që të kalojmë pa... Vetëm titujt. Dakord! Neni 21, nxjerrja e rezultateve të zgjedhjeve nga grupi i numërimit për qendrën e votimit. Kemi diçka për nenin 21. Ju lutem kolegë? Jo! Kalojmë në votimin e nenit 21.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 22. Mbyllja e kutisë me fletët e votimit. Nuk kemi diçka? Kalojmë në votimin e nenit 22.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Kreu 5. Administrimi dhe numërimi i votave të hedhura gabim në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore

Neni 23. Administrimi i votave të hedhura gabim. Kalojmë në votimin e nenit 23.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Neni 24. Numërimi i votave të hedhura gabim.

Kemi diçka për nenin 24? Po, zoti Çaka!



**Z. D. Çaka:** Atëherë, në pikën 1 dhe në pikën 2 të këtij neni janë përcaktuar mënyrat se si do të bëhet numërimi i votave të hedhura gabim, dhe në pikën 1 është cituar që në përfundim të numërimit të votave për të gjithë kutitë e ZAZ-së, KZAZ-ja cakton edhe një herë grupet e numërimit për të bërë kryerjen e vlerësimit. Pra sipas pikës 1 është përcaktuar që pasi të mbyllet numërimi i të gjithë kutive që do të thotë dhe për kandidatë për kryetar bashkie dhe për këshillat bashkiakë, pastaj KZAZ-ja rinis procesin për vlerësimin e votave për vota të hedhura gabim, apo e kam gabim?

**Z. E. Meta:** Saktë!

**Z. D. Çaka:** Ndërkohë, në pikën 2 citohet: “kutia me votat e hedhura gabim për një organ hapet pas përfundimit të numrit të kutive për një organ përkatës”, pra duke iu referuar pikës 2 të duket sikur mbasi mbaron një proces numërimi për kryetarin e bashkisë në atë moment ndodh procesi i numërimit të votave të hedhura gabim. Vlerësoj se të dy këto pika janë në kundërtënie me njëra-tjetrën. Kështu që vlerësoj që pika 2 të hiqet.

**Znj. I. Nano:** Pika 1 e parashikon procedurën e saktë, e dyta është e tepërt, në këtë rast?

**Znj. H.Vukaj:** Është e tepërt? Si e mendon? E ezauron pika 1 edhe pikën 2?

**Z. E. Meta:** Po, pika 1 e ezauron edhe pikën 2.

**Znj. H.Vukaj:** Pra e përfshin?

**Z. E. Meta:** Sepse kutitë me votat e hedhura gabim, numërohen në përfundim të numërimit të votave për kryetar dhe për këshillin.

**Znj. I. Nano:** Atëherë propozimi është për t'u hequr pika 2.

**Kush është dakord koleg?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Kreu 6. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultatit të zgjedhjeve nga KZAZ-ja.

Neni 25. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për kryetarin e bashkisë. Kemi diçka për nenin 25 kolegë? Jo!

Kalojmë në votimin e nenit 25.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Neni 26. Nxjerrja e tabelës përmbledhëse të rezultateve nga KZAZ-ja për këshillin e bashkisë.

Për nenin 26 kemi diçka? Jo!

Kalojmë në votimin e nenit 26.

**Kush është dakord?**

**Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)**

**Kundër: S'ka.**

**Me 5 vota pro miratohet.**

Kreu 7. Hyrja në fuqi.

Neni 27. Hyrja në fuqi dhe ankimi.

1. Ngarkohet administrata zgjedhore për zbatimin e këtij vendimi.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit, pasi gjatë shqyrtimi ka pësuar jo pak ndryshime. Edhe një herë të votojmë në tërësi projektvendimin.

***Kush është dakord?***

***Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)***

***Kundër: S'ka.***

***Me 5 vota pro miratohet.***

Para se të kalojmë tek çështjet jashtë rendit të ditës, do të kërkoja ndërprerjen për 3 minuta të mbledhjes për një konsultim me Sekretarin e Përgjithshëm.


**Rifillon mbledhja**

**Ora 21:17**

***Znj. I. Nano:*** Rikthehemi në mbledhje, sapo kemi miratuar aktin voluminoz dhe të rëndësishëm që kishim për shqyrtim. Gjatë ndërprerjes së shkurtër, Sekretari i Përgjithshëm kërkoi një konsultim me anëtarët e Rregullatorit. Ka diçka për të thënë para se të mbyllim mbledhjen. Po zoti Merkaj.

***Z. Y. Merkaj:*** Faleminderit! Para disa ditësh Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka dërguar një vendim për miratimin e një projektakti, për disa ndryshime në vendimin nr. 11, të dt. 25.03.2021 të Komisionit Rregullator. Tani në këtë

***Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së  
Komisionit Rregullator  
Dt.24.04.2023*

moment ka dërguar një shkresë zyrtare. Nëpërmjet kësaj shkrese thotë: Ju bëj me dije se tërheq propozimin tim për shqyrtimin nga ana juaj të projektaktit për disa ndryshime në vendimin nr. 11, të dt. 25.03.2021, të Komisionit Rregullator “për mënyrën e ngritjes së organizimit dhe funksionimit të Komisionit të Qendrës së Votimit dhe zhvillimin e zgjedhjeve në qendrën e votimit të ndryshuar” për përmirësime të mëtejshme dhe për të paraqitur draftin në një kohë tjetër. Faleminderit!

*Znj. I. Nano:* Faleminderit zoti Merkaj. Duke qenë që nuk kemi çështje të tjera, ato që lamë nga rendi i ditës sot, do t’i shqyrtojmë në mbledhjen e ardhshme. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur . Faleminderit!

**Vendimi nr. 23**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

